



Planuar / Doretuar Prunijeno/Prodato Received/Delivered	27 05 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBICK	3138/2022		118



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.375/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.375/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

në Komunë të Obiliqit, kundër Ri-vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, respektivisht kundër organit të punësimit/Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2021", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.375/2022 e datës 14.04.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. **NDRYSHOHET** Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2021 i datës 12.04.2022 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin nga nota (1.6) në notën e përgjithshme mirë (3).

III. Ky Vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunëses civile.

IV. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Obiliqit, që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Obiliqit, në vendin e punës "Inspektor i Ndërtimit", sipas Akt emërimit të datës 03.02.2017, i pa kënaqur me rivlerësimin e datës 12.04.2022 për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, respektivisht Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim, sipas Vendimit Anr.118/2022 të datës 28.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili vendim ka obliguar Udhëheqësin e drejtpërdrejtë të ankuesit që ankuesit ti bëjë rivlerësimin e rezultateve në punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri e datë 31.12.2021 në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Ankuesi me datë 14.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes emailit zyrtar ankesa.kmshck@rks-gov.net, e protokolluar me numër 2099/2022 kundër rivlerësimit të datës 12.04.2022 me të cilin ankuesi është vlerësuar me notën të përgjithshme 1.6 mjaftueshëm, me të njëjtën not siç është vlerësuar në formularin e vlerësimit për rezultatet në punë për vitin 2021, i lëshuar me datë 01.02.2022, me pretendimet ankimore se rivlerësimi është bërë i njëjtë pa komente dhe prova të cilat do të dëshmonin rivlerësimin në fakte, dhe si i tillë është në kundërshtim me ligjin në fuqi, duke propozuar që ti aprovohet ankesa të anulohet rivlerësimi i datës 12.04.2022 për shkak të mos zbatimit të Vendimit të Këshillit, si dhe duke propozuar që Kryetari i Komunës të ndërmerr veprime ndaj Udhëheqësit të Sektorit për Inspektim, sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e datës 14.04.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes emailit zyrtar ankesa.kmshck@rks-gov.net, e protokolluar me numër 2099/2022; Vendim i datës 28.03.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër Anr.118/2022; Ankesën e ankueses me numër protokolli 691/2022 të datës 11.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 për ankuesin; Përshkrimi i detyrave të punës; Plani nr. protokolli XV-04 i punës për vitin 2021 i datës 08.01.2021; Folder i datës 2021; Procesverbal i datës 18.01.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 20.01.2021; Procesverbal i datës 21.01.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 03.02.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 12.02.2021; Procesverbal i datës 24.02.2021; Procesverbal i datës 16.02.2021; Procesverbal i datës 24.02.2021; Procesverbal i datës 02.03.2021 faqe 1/3; Procesverbal i datës 04.03.2021; Procesverbal i datës 05.03.2021 ; Procesverbal i datës 08.03.2021; Procesverbal i datës 09.03.2021; Procesverbal i datës 16.03.2021; Procesverbal i datës 18.03.2021; Procesverbal i datës 25.03.2021; Procesverbal i datës 31.03.2021; Procesverbal i datës 02.04.2021 faqe 1/3; Procesverbal i datës 05.04.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 12.04.2021 faqe 1/3; Procesverbal i datës 13.04.2021; Procesverbal i datës 15.04.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 26.04.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 27.04.2021; Procesverbal i datës 28.04.2021; Procesverbal i datës 29.04.2021; Procesverbal i datës 30.04.2021; Procesverbal i datës 06.05.2021; Procesverbal i datës 07.05.2021; Procesverbal i datës 11.05.2021; Procesverbal i datës 24.05.2021; Procesverbal i datës 26.05.2021; Procesverbal i datës 27.05.2021;

Procesverbal i datës 01.06.2021; Procesverbal i datës 03.06.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 10.06.2021; Procesverbal i datës 1.06.2021; Procesverbal i datës 05.08.2021; Procesverbal i datës 06.08.2021; Procesverbal i datës 09.08.2021; Procesverbal i datës 12.08.2021; Procesverbal i datës 13.08.2021; Procesverbal i datës 30.08.2021; Procesverbal i datës 20.09.2021; Procesverbal i datës 21.09.2021; Procesverbal i datës 29.09.2021; Procesverbal i datës 04.10.2021; Procesverbal i datës 05.10.2021; Procesverbal i datës 12.10.2021 ; Procesverbal i datës 22.10.2021; Procesverbal i datës 25.10.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 28.10.2021; Procesverbal i datës 09.11.2021; Procesverbal i datës 12.11.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 17.11.2021; Procesverbal i datës 18.11.2021; Procesverbal i datës 19.11.2021; Procesverbal i datës 25.11.2021; Procesverbal i datës 09.12.2021; Urdhëresë për pagesë për ndëshkim me gjobë mandatarë të datës 24.02.2021, të datës 03.03.2021 të datës 25.03.2021 të datës 12.04.2021 të datës 15.04.2021 të datës 26.04.2021 të datës 13.08.2021; Lista e lëndëve të regjistruara faqe 1/8; Raport lidhur me inspektimet nga data 01.1.2021 -31.12.2021; E-mail i datës 24.02.2021; E-mail i datës 08.03.2021; E-mail i datës 05.03.2021; inspektim i datës 08.03.2021; E-mail i datës 09.03.2021; E-mail i datës 10.03.2021; E-mail i datës 11.03.2021 i datës 12.03.2021; Njoftim i datës 08.04.2021; E-mail i datës 4.04.2021; Raport lidhur me inspektimin e datës 13.04.2021; E-mail i datës 16.04.2021; E-mail -Raport i datës 27.04.2021; Raport lidhur me inspektimin e datës 26.04.2021; E-mail i datës 29.04.2021; shkresë e datës 28.04.2021 lidhur me pengesat e mbikëqyrjes inspektuese; E-mail i datës 30.04.2021; E-mail i datës 06.05.2021; Reagim i datës 06.05.2021; E-mail i datës 06.05.2021; E-mail i datës 12.05.2021; Raport i datës 12.05.2021; E-mail i datës 12.05.2021-deklarati; Deklarati e datës 12.05.2021; E-mail i datës 18.05.2021; E-mail i datës 24.05.2021; E-mail i datës 10.06.2021 ;E-mail i datës 23.11.2021 -Njoftim; E-mail i datës 26.11.2021 Raport MEDRUPALAST; E-mail i datës 01.12.2021; E-mail i datës 03.12.2021; E-mail i datës 16.12.2021; E-mail i datës 22.12.2021; E-mail i datës 30.12.2021; Raport i datës 31.12.2021; E-mail i datës 31.12.2021; E-mail i datës 02.02.2021; Vendim i datës 02.02.2021 për kompensim per punë jashtë orarit nr.11-59; Vendim nr.XV-27 i datës 10.02.2021; E-mail i datës 10.02.2021; Kërkesë e datës 10.02.2021; Vendim nr.II-127 i datës 03.03.2021; Email i datës 05.03.2021 -procesverbal; Email i datës 09.03.2021 -Njoftim;Shkresë e datës 08.03.2021 nga Inspektori; E-mail i datës 19.03.2021; Email i datës 06.03.2021 -vendim i Qeverisë CV-19; E-mail i datës 15.04.2021 Rekomandim; E-mail i datës 05.05.2021-Njoftim; E-mail i datës 07.05.2021-Kërkesë per plotësim dhe ndryshim e PZHK Obiliq; E-mail i datës 07.05.2021- scan personeli 007; E-mail i datës 18.05.2021-Njoftim dhe i datës 24.05.2021; E-mail i datës 26.05.2021 plan i zhvillimor; E-mail i datës 27.05.2021 plan i zhvillimor dhe me datë 25.05.2021;E -mail i datës 12.07.2021 -Komision ,harta zonale; E-mail i datës 12.07.2021 dhe i datës 19.07.2021, Vendim -grupi mbështetës i punës; E-mail i datës 19.07.2021 -takim pune; E-mail i datës 19.07.2021-dëmet në bujqësi; E-mail i datës 21.07.2021-takim; E-mail i datës 01.09.2021; E-mail i datës 01.09.2021 Njoftim; E-mail i datës 27.09.2021 -draft HZK Obiliq i dt.30.07.2021; E-mail i datës 22.11.2021 -Njoftim; E-mail i datës 16.11.2021 -Njoftim; Aktvendim nr.XV-172 i datës 18.08.2021; Aktvendim nr.XV-171 i datës 18.08.2021; Fatura e datës 16.08.2021; Aktvendim nr.XV-101 i datës 14.05.2021; Fatura e datës 11.05.2021; Aktvendim nr.XV-84 i datës 28.04.2021; Aktvendim nr.XV-65 i datës 29.03.2021; Aktvendim nr.XV-42 i datës 09.03.2021; Fatura e datës 26.04.2021; Aktvendim nr.XV-72 i datës 16.04.2021; Aktvendim nr.XV-73 i datës 16.04.2021; Aktvendim nr.XV-33 i datës 25.02.2021; Aktvendim nr.XV-30 i datës 19.02.2021; Fatura e datës 04.03.2021; Aktvendim nr.XV-32 i datës 25.02.2021; Aktvendim nr.XV-31 i datës 25.02.2021; **Përgjigje në ankesë e datës 01.03.2021 me nr. protokollin 1074/2022**; Akte emërimi nr.II-105 i datës 03.02.2017 ; E-mail i datës 24.02.2022 njoftim rreth vlerësimit të zyrtarit E-mail i datës 23.02.2022 Njoftim për provat e

kërkuara nga KPMSHCK-së; Dëshmi e datës 24.02.2022 nga H.P, bashkangjitur: Aktvendim nr.XV-38 i datës 08.03.2021; Kallëzimi penal Nr.XV-04 datës 12.01.2022i nxjerrë nga E-mail i datës 11.02.2022 lidhur me e-mailin e datës 09.02.2022; E-mail i datës 15.02.2022 me e-mailin e datës 15.02.2022; Rekomandim i datës 15.04.2021; Sqarim i datës 11.02.2021; E-mail i datës 16.12.2021 -Njoftim; E-mail i datës 20.04.2021-PërgjigjeE-mail i datës 24.05.2021; E-mail i datës 05.03.2021; E-mail i datës 10.03.2021; E-mail i datës 10.03.2021; Vendim Nr.XII-171 i datës 29.12.2021 I Komisionit disiplinor; Rekomandim i datës 18.05.2021 për Zyrën Ligjore, nga -për ndërprerje të punës për

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, nuk është objektiv dhe i pabazuar në prova dhe fakte, gjegjësisht vlerësimi i është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, edhe pse është thirr në takim për të zbatuar Vendimin Anr.118/2022 të datës 28.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i njëjti me datë 12.04.2022 përmes E-mailit zyrtar me datë 12.04.2021, e dërgon Formularin e rivlerësimit të rezultateve në Punë për vitin 2021, për ankuesin me notën e njëjte të përgjithshme 1.6, ashtu siç është vlerësuar dhe në vlerësimin e datës 01.02.2022.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 03.02.2017, është i punësuar në Komunë të Obiliqit, në pozitë "Inspektor i Ndërtimit", në Sektorin për Inspektim në kuadër të Drejtorisë së Inspekcionit, dhe pretendimet e ankuesit janë të bazuara lidhur për faktin se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në e-mailin e datë 12.04.2022 drejtuar ankuesit i ka bashkangjitur rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, dhe ne te njëjtin e-mail e njofton lidhur më zbatimin e Vendimit me numër A.nr.118/2022 të datës 28.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke i shkruar, se, citoj: "*.... po ashtu keni qenë të ftuar në zyre në prani të kolegëve tuaj ju është bërë vlerësimi meqë rast ju nuk mund të mohoni asnjë nga ato prova që ju prezantova gjatë vlerësimit..*", mbi këtë bazë ankuesi me datë 13.04.2022 i është përgjigjur Udhëheqësit të drejtpërdrejtë, përmes e-mailit zyrtar, duke i përkujtuar se provat e prezantuara në takim për rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, nuk qëndrojnë sepse raportet janë trajtuar në seancat e Komisionit disiplinor sipas Vendimit me Nr.XII-25 të datës 03.06.2021 i cili ka refuzuar kërkesën e iniciuar të datës 05.05.2021 dhe te datës 12.05.2021 për komisionin disiplinor, po ashtu ankuesi pretendon se nuk janë marrë për bazë të gjitha të gjeturat sipas Vendimit me numër A.nr.118/2022 të datës 28.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe si i tillë vlerësimi është bërë me tendencë dhe është diskriminues, gjegjësisht ankuesi pretendon se ka argumente dhe dëshmi se ka përmbushur në tërësi dhe ka tejkaluar të gjitha objektivat gjatë kryerjes së detyrave të punës për vitin 2021, dhe se vlerësimi si i tillë nuk është real dhe është i pabazuar sepse nuk ka prova faktike.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *Vlerësimi i rezultateve në punë është*

proces i përlshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar).*, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi sipas të cilës konstatohet se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me ankuesin kanë përcaktuar objektivat e punës në fillim të vitit 2021 konkretisht ankuesi nuk posedon plan individual të punës për vitin 2021, e që është në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku theksohet se : *“Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit”*, sepse plani i punës duhet të hartohet gjithmonë me pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë dhe nëpunësin, duke marrë për bazë përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit dhe nga ajo pjesë duhet të caktohen objektivat përkatëse për realizimin e aktiviteteve, siç ceket edhe në nenin 6 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku theksohet se : *“Brenda muajit janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e nxjerrjes së rivlerësimit të datës 12.04.2022 të rezultateve të punës për vitin 2021, edhe pse ka mbajtur takimin me ankuesin, nuk ka marrë për bazë të gjeturat e Vendimit me numër Anr.118/2022 të datës 28.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa lidhur me komentet e cekura në formularin e rivlerësimit të datës 12.04.2022, që lidhet me mos përmbushjen e detyrave të punës, ku ceket se ankuesi nuk ka treguar aftësi dhe performance për t’ju përmbajtur planifikimit, organizimit dhe koordinimit nga Drejtori i Inspektimit, Kolegji bazë të dëshmive të ofruara konstaton se pretendimet e mbikëqyrësit nuk qëndrojnë sepse ankuesi në bazë të përshkrimit të detyrave të punës ka përmbushur objektivat e tij të punës, të cilën e dëshmon me Planin e përgjithshëm të punës së Drejtorisë së Inspektionit për vitin 2021 me numër protokollit XV-04 i datës 08.01.2021, procesverbalet e procedurave për kontrollin inspektues që fillojnë nga data 18.01.2021 deri me datë 09.12.2021, e që kanë të bëjnë me inspektime ndërtimi, inspektimi në lidhje me masat anticovid 19, ku në të gjitha këto inspektime ka qenë prezent ankuesi, Urdhëresat për pagesë për ndëshkim me gjobë mandatore duke filluar nga data 24.02.2021 deri me datë 13.08.2021, gjithsejtë

janë nga ankuesi janë lëshuar 9 urdhëresa, po ashtu Kolegji ne baze dëshmisë se ofruar konkretisht listës se inspektorëve të pranishëm në teren për gjatë vitit 2021 ka konstatuar se me këtë listë dëshmohet se ankuesi gjate gjithë vitit 2021 ka qene ne teren ne vizita inspektueseë respektivisht ka qenë efektiv në kryerjen e detyrave të punës ku dëshmohet edhe ne baze te kësaj liste në forme tabelorë, duke specifikuar gjendjen e inspektimit dhe masat e marra me procesverbale, aktvendime të ndërmarra, urdhëresa, gjoba mandatorë etj, po ashtu te gjitha këto pune janë dëshmuar edhe me raporti vjetor te punës të ankuesit të datës 31.12.2021.

Duke u bazuar në këto dëshmi të ankuesit dhe pretendimet se tij se rivlerësimi i rezultateve të punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk është real, është tendencioz dhe i pabazuar në prova dhe fakte sepse rivlerësimi i rezultateve te punës nuk është bazuar në raportet dhe aktivitetet e tij në punë, Kolegji ka konstatuar se pretendimet janë te bazuara sepse duke u bazuar në prova, gjegjësisht tek formulari i vlerësimit tek pjesa e objektivave, Kolegji ka gjetur se në të katër (4) objektivat nuk janë përfshirë të gjitha aktivitetet dhe detyrat e punës së ankuesit, e që ky veprim është në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, si dhe në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: "1. Vlerësimi i rezultateve në punë përmban: 1.1. matjen e realizimit të objektivave të përcaktuara - objektivat janë prioritetet e punës së nëpunësit dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar; dhe 1.2. matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit - sjelljet profesionale janë aftësitë profesionale të nëpunësit të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësiive në punë, që përfshinë: 1.2.1. planifikimin dhe organizimin; 1.2.2. vendimmarrjen; 1.2.3. motivimin, zhvillimin dhe trajtimin e paanshëm; 1.2.4. iniciativën dhe kreativitetin; 1.2.5. komunikimin dhe përfaqësimin; dhe 1.2.6. efektivitetin në punë", andaj rivlerësuesi nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, me rastin e rivlerësimit te rezultateve te punës të datës të 12.04.2022 për vitin 2021 ankuesin duke i vendosur notën e përgjithshme të njëjte 1.6.

Kolegji ka analizuar formularin e vlerësimit të rivlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 dhe ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë me rastin e rivlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin, respektivisht përcaktimit të notës mesatare nuk ka zbatuar udhëzimet e rregullores të përcaktuara si në nenin 10 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: "1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit; 2. Nota mesatare e objektivave kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë objektivave të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e objektivave të vlerësuar; 3. Nota mesatare e sjelljeve profesionale (aftësiive) kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë aftësiive të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e aftësiive të vlerësuar; 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësiive", ngase sipas rivlerësimit me formulën e përcaktuar si më lartë nota e përgjithshme e vlerësimit del të jetë një pikë gjashtë (1.6), ndërsa në bazë të kalkulimit sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje del të jetë më e ulët respektivisht nota e përgjithshme del të jete 1.11 duke mbledhur notën e objektivave që del të jetë 1.05 dhe notën e aftësiive që del të jetë 0.06.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që ankuesi në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 24.12.2019 dhe 22.01.2021 është vlerësuar me notë të përgjithshme 3.28 respektivisht 3.6, po nga i njëjti vlerësues për të njëjtat objektiva dhe aftësi, ndërsa për vitin 2021 është vlerësuar shumë me ulët, si rrjedhojë Kolegji, ka ardhur në përfundimin se ekziston baza e mjaftueshme ligjore sikurse edhe fakte dhe prova konkrete se ankuesi ka arritur objektivat dhe sipas neni 13 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, *Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)*, vendos t'i ndryshojë notën e vlerësimit notën e përgjithshme nga 1.6 në tre (3), siç përcaktohet me dispozitat e nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 si dhe paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 i të njëjtit nen të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *"Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton " mirë"; dhe Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: " mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës"*.

Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafin 1 ,2 paragrafin 3 ,7 dhe 10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, është konstatuar se rivlerësimi për rezultatet e punës për vitin 2021 për ankuesin është bërë në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe si i tillë është i pa ligjshëm siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: ***"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:.....1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative"***.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit është e obliguar që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2021 e zëvendëson ky vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita

në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.375/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.